BASHKIA KAMEZ

DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

# RELACION TEKNIKE

## PER PROJEKTIN E ZBATIMIT

## OBJEKTI :

## NDERTIM RRUGET

## "Burimi, Gucia, Faik Hoxhaj(ish Miqesia), 3 seg.pingul me Rrugen Faik Hoxha"

## Kamez 5

## BASHKIA KAMEZ

**PUNUAN :**

Ing. Arjola Kurti

Ing. Denis Prençi

Drejtore e Projekteve dhe Investimeve

FloraMuça

**MIRATOI**

**Rakip SULI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KAMZ
KRYETAR

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT


## 1. – TË PËRGJITHSHME

1.1 – Hyrje
1.2 – Pozicioni i objektit
1.3 – Qellimi i projektit

## 2. – GJENDJA EKZISTUESE DHE ZGJIDHJA E PROJEKTIT

2.1 – Gjendja ekzistuese dhe Nderhyrjet
2.2 – Projekti Rrugeve dhe Trotuareve
2.3 – Rrjeti Ujesjellesit
2.4 – Rrjeti K.U.Z.
2.5 – Rrjeti K.U.SH.
2.6 – Sistemi i Ndriçimit Rrugor
2.7 – Sinjalistika Rrugore

## 3. – PREVENTIVI I PUNIMEVE

# 1. - TË PËRGJITHSHME

## 1.1 - HYRJE

Bashkia Kamëz ndodhet 7 km larg kryeqytetit, Tiranës, në veriperëndim të saj. Kufizohet nga veriu me Krujën, nga jugu me Tiranën, nga lindja me Zall-Herrin dhe nga perëndimi me Bërxullin. Terreni në përgjithësi është i sheshtë, me një pjerrësi të lehtë drejt veriperëndimit. Zona ndodhet në një kuotë që varion nga 80-90 m mbi nivelin e detit në pjesën jugore, që zbret në 45 m mbi nivelin e detit, pranë aeroportit të Rinasit në pjesën veriore. Përshkohet nga rruga kombëtare që lidh kryeqytetin me veriun e vendit.

Kamëza ndodhet në trekëndëshin strategjik: kryeqyteti Tiranë - aeroporti i Rinasit - porti i Durrësit

Bashkia Kamëz pas ndarjes së re territoriale përfshin nën administrimin e saj edhe njësinë administrative Paskuqan.




Qyteti i Kamzes gjate viteve te fundit ka pesuar nje rritje te ndjeshme te popullsise si dhe nje zhvillim te pergjithshem me ritme teper te larta. Tashme Kamza eshte kthyer ne nje qender e rendesishme tregtare dhe ekonomike . Ky zhvillim dhe rritja e konsiderueshme si e automjeteve te qytetit te Kamzes, ashtu edhe levizja teper intensive e trafikut si me qytetet e tjera ashtu edhe me shtetet fqinje, kerkojne nje sistem rrugor te zhvilluar.

Aktulisht akset kryesore te qytetit te Kamzes jane rikonstruktuar apo zgjeruar. Nderkohe qe ndihet nevoja e hapjes se rrugeve dhe koridoreve te reja te levizjes. Problematike gjithashtu paraqiten rruget dytesore dhe tretesore ne brendesi te blloqeve te banimit. Te cilat ndikojne direkt ne qarkullimin dhe cilesine e jeteses se banoreve te tyre si te te mbare qytetit ne teresi.

Ne kete kuader Bashkia e Kamzes, ka planifikuar pergatitjen e nje sere projektesh per rikonstruksionin dhe rikualifikimin urban te nje sere blloqesh banimi apo segmenteve rrugore. Trajtimi i blloqeve, segmenteve rrugore do te jete i plote ne te tere komponentet e nevojshem. Nder keto segmente rrugore dhe blloqe banimi, eshte edhe objekti qe do trajtohen nga ky projekt.

## 1.2 - POZICIONI I OBJEKTIT

Objekti shtrihet ne qytetin e Kamzes, Bathore.

Rruget jane ekzistuese dhe konturohet nga objekte te reja nga te dy anet, pasi zona ku kalon kjo rruge eshte nje zone ne zhvillim.

Rruga Burimi me gjatësi - 225ml
Rruga Gucia - 145ml
Rruga Faik Hoxha (ish Miqesia) + 3 seg pingul me Faik Hoxhen
-425+105+130+110ml

Rruga Burimi - UTM

| | X | Y |
|---|---|---|
| **Fillimi i Rruges** | **481108.41** | **4583375.93** |
| **Fundi i Rruges** | **480891.88** | **4583316.82** |

Rruga Gucia - UTM

| | X | Y |
|---|---|---|
| **Fillimi i Rruges** | **481392.74** | **4583248.94** |
| **Fundi i Rruges** | **481266.63** | **4583191.02** |

Rruga Faik Hoxha (ish Miqesia) + 3 seg pingul me Faik Hoxhen - UTM

| | X | Y |
|---|---|---|
| **Fillimi i Rruges** | **481527.82** | **4582931.04** |
| **Fundi i Rruges** | **481252.17** | **4583046.77** |



## 1.3 – QELLIMI I PROJEKTIT

Objekt i projektit do të jetë rikonstruksioni i plote i rrugeve **NDERTIM RRUGET "Burimi, Gucia, Faik Hoxha ( ish Miqesia) + 3 seg pingul me rrugen Faik Hoxha"** me të gjithë elementët e infrastrukturës rrugore dhe urbane, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit të kësaj zone dhe krijimin e akseseve te levizjes me rruget e tjera te qytetit. Zona ku kalon rruga cdo dite po merr zhvillim duke u shtuar numri i banoreve dhe gjendja e rruges vjen duke u perkeqesuar ndaj lind nevoja e ndertimit te nje rrugeve te reja me standarte bashkekohore duke lehtesuar jeten e banoreve dhe duke permiresuar qarkullimin e automjeteve.

# 2. – GJENDJA EKZISTUESE DHE ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Projekt Ideja per ndertimi i rrugeve " Burimi, Gucia, Faik Hoxha ( ish Miqesia) + 3 seg pingul me rrugen Faik Hoxha ", eshte realizuar ne baze te Detyres se Projektimit te dhene nga Bashkia Kamez.

*Realizimi i ketij projekti eshte mbeshtetur mbi standartet dhe kushtet teknike CNR dhe ato Shqiptare. Duhet theksuar qe pergjithesisht segmentet rrugore te ketij blloku ne pamundesi te zgjerimit, parametrat gjeometrike te tyre jane jashte standarteve.*

Ne kete objekt eshte parashikuar ndertimi dhe rikonstruksioni i rrjetit rrugor si dhe i rrjeteve inxhinierike si: kanalizime, rrjeti i ndricimit, kub etj.

## 2.1 – GJENDJA EKZISTUESE

Keto rruge jane segmente rrugore te rendesishem pasi lidhet direkt me rrugen kryesore . Aktualisht paraqitet pothuaj teresisht i amortizuar në pjesën ekzistuese.

Pjesa e rruges eshte pa shtresa rrugore dhe pa infrastrukture inxhinierike e konturuar nga objekte te reja shume kateshe, objekte banimi 2-3 kate dhe objekte ne ndertim e siper.

Nje pjese e rruges kerkon prishjen e disa mureve rrethuese per tu realizuar.

*Foto te gjendjes ekzistuese Rruga Burimi*





*Foto te gjendjes ekzistuese Rruga Faik Hoxha ( ish Miqesia)*





*Foto te gjendjes ekzistuese Rruga Gucia*





Rruget jane ne gjendje te keqe me gropa, pa trotuare qe qytetaret te kene mundesi te kalojne pra rruga eshte ne gjendje natyrore. Ne zona te vecanta, investitoret qe kane ndertuar objekte banimi. Aktualisht ky segment eshte teresisht I degraduar. Ujrat rrjedhin sipas pjerresise se terrenit, duke krijuar pellgje e balte. Ne periudhen e thate, pluhuri eshte elementi dominues ne rruge, Edhe ne kete segment ndertimet e bera, nuk jane ne uniformitet persa i takon planvendosjes.

Rrjetet inxhinierike jane te demtura dhe nuk funksionojne me kapacitet te plote.

## 2.2 – ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Sipas Termave te References eshte kerkuar qe ky bllok te plotesoje keta parametra gjeometrike:

- ✓ *Gjeresia e pergjitshme e kurores 5m dhe 7m*
- ✓ *Gjeresi e pjeses kaluese 4 dhe 4,5m,,*

*Profil terthore Rruget "Burimi, Gucia, Faik Hoxha ( ish Miqesia) + 3 seg pingul me rrugen Faik Hoxha",*




*Asfaltobeton - 3cm*
*Binder - 5cm*
*Stabilizant - 10cm*
*Cakell - 20cm*
*Mbushje me Cakell e gur gurore*

Duke pare gjendjen aktuale te rrugeve, pozicionet e objekteve qe konturojne ate, kerkesat e Termave te References, grupi i projektimit ka pergatitur projekt zbatimin.
Gjurma e rruges eshte krijuar duke ju referuar aksit te te miratuar nga Bashkia Kamez si dhe Profilit Tip te percaktuar ne Detyren e Projektimit. Ky Projekt zbatimin i eshte referuar gjithashtu dhe Variantit te miratuar ne Keshillin Teknik te Drejtorise se Pergjithshme te Puneve Publike ne Bashkine e Kamzes

Paketa e shtresave per segmentin do jene:
*Asfaltobeton - 3cm*
*Binder - 5cm*
*Stabilizant - 10cm*
*Cakell - 20cm*
*Mbushje me Cakell e gur gurore*

## Rrjeti KUSH

Eshte parashikuar realizimi i rrjetit te ri per KUSH i cili parashikon ndertimin e pusetave te reja. Rrjeti i ri i KUSH parashikon vendosjen e tubave polietileni te brinjezuar SN 8 me diameter 315,mm si dhe shkarkimin ne te te pusetave ujembledhese (pusete me zgare kompozit). Shkarkimi do te behet ne pusete ekzistuese.







## Rrjeti KUZ

Eshte parashikuar gjithashtu realizimi i rrjetit te K.U.Z. Rrjeti ne fjale parashikon vendosjen ne aks te rruges tubin i cili do te realizohet me tuba polietileni te brinjezuar SN 8 me diameter 315 dhe realizimi i pusetave te kontrollit te cilat do sherbejne per shkarkimet e banesave, dhe te rrugicave ne krah te saj. Tubacioni do te shkarkoje ne pusten ekzistuese duke I larguar keshtu nga zona e banuar

## Ndricimi Rrugor-

Eshte parashikuar ndertimi i ndricimit rrugor. Linja e ndricimit do te vendoset ne te nje anet e rruges. Pusetat e ndricimit do te vendosen cdo 30m. Furnizimi me energji do te behet nga kabina ekzistuese.

## Sinjalistika Rrugore

Ne projekt eshte parashikuar gjithashtu vendosja dhe realizimi i sinjalistikes perkatese se nevojshme, e cila perbehet si nga ajo horizontale ashtu edhe ajo vertikale

(shikoplanimetrineesinjalistikes).

TREKENDESHI: E KUQE REFLEKTUESE
SFONDI: I ZI
SIMBOLI: E BARDHE REFLEKTUESE

TRIANGLE: RED REFLECTIVE
BACKGROUND: WHITE REFLECTIVE
SYMBOL: BLACK




## SHENJA NDALUESE

SHENJAT PER KUFIRIN E SHPEJTESISE DHE NDALIM PARAKALIMIN

RRETHI: E KUQE REFLEKTUESE
SHENJA: E ZEZE REFLEKTUESE




1: SHENJAT RRUGORE PER NGA FORMA, MADHESIA, NGJYRA REFLEKTIVITETI DUHET TE JENE SIPAS KODIT RRUGOR TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE
MATERIALI PRAPAREFLEKTIV DUHET TE KETE JETEGJATESI 10VJET PER CLASIN 2 DHE 7 VJET PER CLASIN I
SIMBOLI BRENDA SHENJES RRUGORE DUHET TE JETE I REALIZUAR ME BOJE TE TRAJTUAR ME PJEKJE E CILA NUK HUMBET TREGUESIT PRAPAREFLEKTIV
SHENJA RRUGORE REALIZOHET ME LLAMARINE ÇELIKU E CILA LYHET ME BOJE OPAKE KUNDRANDRA KOROZIONITDHE TRAJTOHET ME PJEKJE.